




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.9, datë 06.03.2023



PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK
SHOQËRISË “ERA HYDRO” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë “Era Hydro”, sipas kontratës me Nr. 16 Rep., Nr. 12/1 Kol., datë 05.01.2018 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Strori” . të lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Shoqërisë “Era Hydro” sh.p.k. Me vend ndodhje në përroin e Seltës dhe Holtës degë të lumit Devoll Bashkia Gramsh Qarku Elbasan.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC Strori

Vendndodhja e veprës së marrjes 1/ burimi ujqor Përroi i Holtës

- X= 518521; Y= 4532420; Z=241.75 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritore: 5.2 m³/s



- Prurja mesatare vjetore: 4.2 m³/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.76 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.28 m³/s
- Prurja për bujqësi: 0.06 m³/s

Vendndodhja e veprës së marrjes 2 në dalje të kanalit të shkarkimit fundor të HEC Tervoli/ burimi ujqor Përroi i Holtës

- X= 518512; Y= 4532496; Z=242.5 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 5.2 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 4.2 m³/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.76 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.28 m³/s
- Prurja për bujqësi: 0.06 m³/s

Vendndodhja e godinës së Centralit

- X= 514038; Y= 4532115; Z=179 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: 5.2 m³/s
- Prodhimi vjetor i parashikuar: 7.764.000 kwh/vit
- Fuqia e instaluar: 2.000 kwh
- Vlera totale e investimit: 480,891,928 lekë

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit te subjektit te interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ

